

VENDIM
Nr. 344, datë 19.4.2017

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 970, DATË 2.12.2015, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE DHE TË KUSHTEVE PËR DHËNIEN E LICENCAVE PËR TREGTIMIN E NAFTËS BRUTO DHE NËNPRODUKTEVE TË SAJ"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 19, 20 e 21, të ligjit nr. 8450, datë 24.2.1999, "Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Energjisë dhe Industrisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr.970, datë 2.12.2015, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në kreun I, pika 3, shkronja "ç", ndryshohet, si më poshtë:

"ç) Dokumentacioni që vërteton se depozitat dhe linjat përkatëse teknologjike që realizojnë funksionimin e tyre si dhe magazinat në rastin e tregtimit të vajrave lubrifikante janë ndërtuar në përputhje me legjislacionin në fuqi për planifikimin e territorit."

2. Në kreun II, bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:

- Shkronjat "a" dhe "c", të pikës 2, ndryshohen, si më poshtë:

"a) Ekstraktin historik dhe tregtar të regjistrit tregtar nga Qendra Kombëtare e Biznesit, ku në objekt të ketë të përcaktuar veprimtarinë e tregtimit të naftës bruto dhe/ose nënprodukteve të saj;

c) Dokumentacioni që vërteton se stacioni i shitjes së karburantit është ndërtuar në përputhje me legjislacionin në fuqi për planifikimin e territorit ose që është në procedurë legalizimi në përputhje me legjislacionin në fuqi."

- Shkronja "ë", shfuqizohet.

- Pas pikës 6, shtohet pika 6.1, me këtë përmbajtje:

"6.1 Në rast se personi juridik nuk riparaqet dokumentacionin e kërkuar, brenda 45 (dyzet e pesë) ditëve, autoriteti licencues në përputhje me parashikimet ligjore ndërmerr të gjitha masat e nevojshme për bllokimin e aktivitetit tregtar, deri në riparaqitjen e dokumentacionit të plotë nga ana e personit juridik, për pajisjen e tij me licencë për tregtimin me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm, të naftës për automjetet, vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë."

- Pika 9 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"9. Paga për dhënie dhe përsëritjen e licencave për stacionet e shitjes së karburanteve, gazit të lëngshëm, të naftës për automjetet dhe vajrat lubrifikante, është 3 000 000 (tre milionë) lekë për Bashkinë e Tiranës dhe 1 000 000 (një milion) lekë për bashkitë e tjera."

- Pika 10 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"10. Paga për dhënie dhe përsëritjen e licencave për njësitë e shitjes së lëndëve djegëse, që ushtrojnë veprimtarinë e tregtimit të tyre për përdorim nga konsumatorët fundorë, është 500 000 (pesëqind mijë) lekë për Bashkinë e Tiranës dhe 100 000 (njëqind mijë) lekë për bashkitë e tjera."

- Pas pikës 15, shtohen pikat 15.1 dhe 15.2, me këtë përmbajtje:

"15.1 Në përputhje me legjislacionin në fuqi, organi që ka për detyrë të japë licencën informon, menjëherë, inspektoratin shtetëror përgjegjës dhe bashkëpunon me të për marrjen e masave të bllokimit të veprimtarisë së subjekteve që ushtrojnë, pa licencë, aktivitetin e tregtimit me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm, të naftës për automjetet, vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse, për përdorim nga konsumatorët fundorë.

15.2 Në përputhje me legjislacionin në fuqi, organi që ka për detyrë të japë licencën informon Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve për subjektet e licencuara dhe

vendndodhjen e pikave të depozitimit apo të tregtimit, në mënyrë që këto të fundit të kontrollojnë zbatueshmërinë e legjislacionit në fuqi.”.

II. Ngarkohen Ministria e Energjisë dhe Industrisë, Ministria e Transportit dhe Infrastruktura-rës, Qendra Kombëtare e Biznesit dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

Niko Peleshi